

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI FILOZOFIK

Programi i studimeve Master: Psikologji Shkollore dhe Këshillim



PUNIM DIPLOME

Mentorja:

PhD: Kaltrina Kelmendi

Kandidatja:

Almira Latifi

Shtator, 2023

PËRMBLEDHJE

Thelbi kryesor i këtij hulumtimi është promovimi i mirëqenies subjektive te nxënësit, përmes aktiviteteve të të mësuarit social emocional. Edhe pse në vendin tonë nuk janë realizuar studime të tilla më parë, ky hulumtim mund të konsiderohet si pikënisje e hulumtimeve të tilla intervenuese. Gjithashtu, ky hulumtim intervenues ka për qëllim që mësuesëve t'u ofrojë informacion për përzgjedhjen dhe zbatimin e programeve të të mësuarit social emocional në shkollat e tyre. Literatura tregon se intervenimet e të mësuarit social emocional synojnë të përmirësojnë dinamikën e klasës në përgjithësi si dhe të kenë potencialin për të rritur mirëqenien e nxënësve dhe të mësuesve.

Sipas rrjedhës së punimeve shkencore dhe natyrës së hulumtimit në fjalë, ky punim fillon me abstraktin përmbledhës për të arriturat gjatë këtij intervenimi. Në hyrje të hulumtimit, apo kapitulli i parë paraqiten variablat, ndërlidhja ndërmjet tyre, pyetja kërkimore si dhe hipotezat e hulumtimit. Kapitulli i dytë përmbanë pjesën e perspektivës teorike, në të cilin shqyrtohen teoritë që mbështesin variablat e studimit. Shqyrtimi i literaturës, kapitulli i tretë, paraqet definimin e variablave, përmbledhje e gjerë e studimeve dhe literaturës së shqyrtuar mbi variablat dhe konceptet e këtij hulumtimi. Kapitulli i katërt, metodologjia, përfshinë pjesëmarrësit, instrumentet, dizajnin dhe procedurën e realizimit të këtij hulumtimi. Rezultatet e arritura nga intervenimi paraqiten në kapitullin e pestë, ndërsa në kapitullin e gjashtë paraqitet diskutimi, që përmbanë limitimet dhe rekomandimet.

Qëllimi i këtij studimi është të përcaktojë rolin, rëndësinë, ndërlidhjen dhe ndikimin që e kanë aktivitetet e të mësuarit social emocional në mirëqenien e nxënësve në shkollë. Bazuar në

qëllimin dhe shqyrtimin e literaturës, ky studim ndërtohet mbi një pyetje kërkimore, prej së cilës rrjedhin dy hipoteza në vazhdim:

PK: Cili është roli i aktiviteteve të të mësuarit social emocional (SEL) të realizuara në klasë në mirëqenien subjektive të adoleshentët e hershëm?

H1: Nxënësit që marrin pjesë në aktivitetet e SEL të organizuara në klasë, shënojnë pikë më të larta në mirëqenien subjektive në krahasim me nxënësit që nuk marrin pjesë në këto aktivitete.

H2: Para aktiviteteve SEL në klasë, grupi eksperimental shënon më pak pikë në mirëqenien subjektive se sa pas pjesëmarrjes në këto aktivitete.

Pjesëmarrës në këtë hulumtim janë gjithsej 54 nxënës, të ndarë në dy grupe, grupi eksperimental dhe ai kontrollues. Fillimisht të dy grupet i'u nënshtruan para testit, pastaj vetëm grupi eksperimental mori pjesë në intervenime. Në fund, përsëri të dy grupet i'u nënshtruan pos testimit. Të gjitha të dhënat u vendosën në Paketën Statistikore të Shkencave Sociale (SPSS), ku u analizuan dhe përpunuan në përputhshmëri me objektivat e studimit. Duke aplikuar analizat statistikore të duhura, u gjet se ekziston ndërlidhje në mes të aktiviteteve të të mësuarit social emocional të organizuara në klasë dhe mirëqenies subjektive të nxënësve. Mirëpo, nuk u gjet se këto aktivitete ndikojnë në mirëqenien subjektive të nxënësve në shkollë.

Rezultatet e paraqitura në këtë hulumtim janë në përputhje me një model hierarkik dhe gjithashtu japin prova se konstrukte të caktuara të aspektit social dhe emocional mund të diferencohen në mënyrë të konsiderueshme, të paktën në marrëdhëniet e tyre me aspektin e mirëqenies subjektive. Studimet e ardhshme që do të realizohen, mund të bazohen në adresimin e kufizimeve të këtij studimi.